

STILI

Figurat e Krahasimit dhe Analogjisë

Këto figura ndihmojnë me konkretizua abstraksionet ose diçka që është e vështirë të kuptohet. Ato e arrijnë këtë duke tregua ngjasí në mes entitetesh a idesh të ndryshëme, veçsisht të së panjohunës me të njohunën.

Analogjia (krahasimi i zgjatun)

Nëpërmjet një krahasimi të zgjatun, natyra e diçkaje shpjegohet nëpërmjet natyrës së diçkaje tjetër; ose esenca e diçkaje nëpërmjet esencës së diçkaje tjetër, p.sh., *universitetet mund të quhen supermarketet ditunie*. Në supermarket, paguan dhe merr molla. Në universitet, paguan dhe merr mësim. Stacioni i trenit mund të quhet neu kryesor i një rrjeti qarkullimi. Këtu, rrugët e hekurudhat shihen si rrjetë. Fjala e vetëme ‘rrjetë’ është trope; rrugët mund të shihen si rrjetë, porta e lojës së futbollit ka rrjetë, interneti quhet rrjetë. Kjo trope është imazhi qëndror i analogjisë sepse po ta thjeshtonim këtë analogji, do të përfundonim me një metafor (trope) rrugët = rrjetë.

Kapiteni i anijes mund të krahasohet me prindin, drejtuesin e një kompanie, ose udhëheqësin e një shteti.

- *Kapitenit të anijes i dubet me lundrua nëpër ujëna me valë të nëlta, erë të fortë, shí, e borë.*
- *Drejtuesit të kompanisë i dubet m’e drejtua kompaninë nëpër pasiguritë e marketit, ngritjes së çmimeve të karburantit, anmiqsinë e konkuresve, dhe pasigurinë e së ardhëmes.*

Analogjia mund të jetë relativisht e shkurtë, por ajo edhe mund të kërkojë paragrafe të tana. Krahasimet e zgjatuna na japin figurën e analogjisë, por në esencë ajo që ne thona është: *prind = kapiten = drejtues*. Procesi kognitiv i analogjisë punon në këtë mënyrë. Imagjino një person që nuk i kupton detyrat e kapitenit të anijes, por ai kupton detyrat e prindit. Në përdorimin e analogjisë, kur thona prind = kapiten, ne nuk po e përdorim këtë trope si figurë letrare, por si mënyrë *me i shpjegua dikujt* diçka që ai ose ajo nuk e kupton; që është e panjohun për të.

Alegoria (metafora e zgjatun)

Kjo metaforë e zgjatun mund të aplikohet te një vepër e tanë dhe ku elementet e saj (personazhet, mjedisi, etj.), kanë vlerë simbolike. Një vepër e tillë është *Ferma e Kafshëve* e Orwellit. Në gjuhën shqipe, *Vaji i Bylbylit* i Mjedjes mund të merret si alegori (shih Tropet).

Parabla (mësimi)

Ky tregim i shkurtë përdoret me i dhanë dikujt një mësim moral a filozofik, p.sh., I jati e paralajmënon të birin që të mos fluturojë afër diellit sepse do t’i digjeshin krahët. Djali nuk e dëgjoi këshillën, prandaj atij iu dogjën kahët dhe rá në detë.

Parablet mund të jenë krijime të ligjruesit ose shkruarit. Fakti që ato mund të mos jenë të vërteta është i parandsishëm. Vlera e parablave qëndron në vlerën e mësimet. Por, mësimi nuk mund të merret në mënyrë statike. Një parabel mund të ketë shumë mësimet. Për shembull, në parablën e masipërme, mësimet mund të jenë: *dëgjo prindët, kontrollo vetveten, njihje vetveten, mos e tepro*, etj.

Shembulli (paradigma)

Veçsisht shembuj të spikatun prej historisë ose mitologjisë mund të tregojnë që një ngjarje a aspekt i jetës së tashme ndjekë ligje të provuome historikisht ose mitologjikisht. Për shembull, *Gjelina jep jetën e saj me ringjallë besën*. Përse ishte e nevojshme një gjâ e tillë? Qartisht, shoqnia ishte bâmë e pabesë, ose kishte nisun me adhurua mohin. Një politikan mund t'i referohet këtij miti me tregua që *qeveria e kobës doli e pabesë ndaj votuesve; nuk i mbajti premtimet*.

Në këte shembull, vepra e Gjelinës merret si zbritje e esencës së arbanikëve të lashtë; presupozohet që bésa është esenca e shqiptarit, prandaj ai nuk mund të jetojë nën një 'qeveri të pabesë'.

Theksim nëpërmjet Zbërthimit (merismus, distributio)

Kjo figurë zmadhimi (en. amplification) i ngjan konceptit të analizës ose zbërthimit të tansisë në pjesë. Ajo kërkon që autori ta ndajë një problem në pjesët përbâse, the t'i analizojë ato një nga një. Kështu rreziku i problemit shpjegohet në detaje dhe duket ma gjithpërfshisë; zmadhohet.

Imagjino sikur dikush dëshiron ta bindi audiencën e tij që teknologjia është problemi mâ i madh i kohës sonë:

Me kuptua krizën e teknologjisë, a) shiko duart që nuk punojnë, b) sytë që shikojnë vetëm ekrane, c) mendjet që kopjojnë, dhe ç) gojët që heshtin. Atherë do ta kuptosh që teknologjia nuk është një mjet, por një mënyrë jetese.

Duke e ndá problemin (këtu teknologjinë) në përbasit e saj problemi smadhohet sepse secili përbasë ka një problem të vetin. Kështu, teknologjia nuk është vetëm një problem; ajo është një problem shumfish. Shmfishimi është zmadhim.

